



USHTRIA



Viti i 78-të i botimit Nr. 44 (827949)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 7 nëntor 2025

Akti Normativ i Buxhetit 2025 forcon mbështetjen për Mbrojtjen Kombëtare: “Made in Albania” në qendër të zhvillimit ushtarak



» faqe 3



FORCAT E ARMATOSURA DHE FSK FORCOJNË BASHKËPUNIMIN STRATEGJIK

Ekipi drejtues i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, i kryesuar nga Drejtori i Shtabit, gjeneral brigade Ardian Lilo, përmbylli një vizitë zyrtare në Republikën e Kosovës. Gjatë kësaj vizite, u zhvilluan takime me drejtues të lartë të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) dhe të institucioneve...



faqe 4



AKADEMIA E NËNOFICERËVE “THOMSON”, TRADITA DHE RRUGA E FORMIMIT TË “SHTYLLËS KURRIZORE” TË USHTRISË SHQIPTARE

Nga themelimi i parë i shkollave të nënoficerëve, në vitin 1919, deri te Akademia bashkëkohore e Arsimit Profesional të Nënoficerëve – një histori përkushtimi, profesionalizmi dhe përparimi në shërbim të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë...



faqe 6



PARA SE TË VRAPOSH, MËSO TË ECËSH! UDHËTIMI DREJT MAJËS FILLON ME HAPIN E PARË

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Rrugëtimi që forcon karakterin, hapat që çojnë drejt nderit. Në çdo mëngjes ushtarak, kur zëri i trombës zgjon repartet dhe rreshtat mbushen me hapa të sinkronizuar, në atë ritëm të rregullt fshihet një mësim i lashtë, që vlen jo vetëm për uniformën, por për jetën: para se të vraposh, mëso të ecësh. Kjo shprehje e thjeshtë përmbledh filozofinë e përgatitjes, durimit dhe përlësisë, tri shtylla që mbajnë në këmbë jo vetëm formimin ushtarak, por edhe njeriun në çdo fushë të jetës...



faqe 8

Ekspertët shqiptarë marrin pjesë në stërvitjen kibernetike “Crossed Swords 2025” të NATO-s

Ekspertët nga Komanda Kibernetike dhe e Ndërlidhjes morën pjesë këtë javë në një nga stërvitjet më komplekse kibernetike të organizuara nga Qendra e Ekselencës për Mbrojtje Kibernetike e NATO-s (CCDCOE), e njohur me emrin “Crossed Swords 2025”, ku morën pjesë përfaqësues nga mbi 40 vende të ndryshme.

Stërvitja u zhvillua në mjediset e CR14, ku skenarë realistë dhe dinamikë testuan zinxhirin e plotë të operacioneve kibernetike – që nga simulimet e sulmeve, te kundërmasat, analiza dhe vendimmarrja shumë-domainëshe.

Në këtë aktivitet u integruan elementë teknikë, ligjorë dhe strategjikë, si dhe u theksua bashkëpunimi ndërmjet njësive kibernetike dhe strukturave të tjera operationale të vendeve aleate.

Pikat kryesore të stërvitjes:

- Operacione të drejtuara në nivel kombëtar dhe NATO;
- Skenarë të avancuar të sulmeve dhe mbrojtjes kibernetike;
- Vendimmarrje teknike, ligjore dhe strategjike në kohë reale;
- Eksperimentim me inteligjencë artificiale për vetëdije operationale të situatës;
- Forcim i bashkëpunimit ndërkombëtar dhe mbrojtjes kolektive.

“Crossed Swords” nuk është thjesht një stërvitje, por një



provë reale e rezistencës kibernetike, e gatishmërisë dhe e koordinimit midis aleatëve përballë kërcënimeve moderne në hapësirën digjitale.

Ekspertët shqiptarë kanë kontribuar me profesionalizëm, duke dhënë një shembull të qartë të angazhimit të Shqipërisë në sigurinë dhe mbrojtjen kolektive të Aleancës.



Ekipi shqiptar merr pjesë në stërvitjen kibernetike rajonale “CybExer 2025”

Një ekip shqiptar, i përbërë nga përfaqësues të Komandës Kibernetike dhe Ndërlidhjes, Agjencisë Kombëtare për Siguri Kibernetike (AKSK), Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) dhe Policisë së Shtetit, mori pjesë në stërvitjen rajonale kibernetike “CybExer 2025”.

Aktiviteti organizohet në kuadër të Programit të Trajnimit Kibernetik të Ballkanit Perëndimor, nën kujdesin e e-Governance Academy (eGA) dhe Bashkimit Europian.

Gjatë këtyre ditëve të stërvitjes, pjesëmarrësit u trajnuan mbi zbulimin dhe mbrojtjen ndaj sulmeve kibernetike, duke përfshirë edhe një sesion praktik “live fire”, ku ushtrohen teknika të kërkimit të rreziqeve në kohë reale dhe reagimit ndaj incidenteve të simuluar.

Në “CybExer 2025” morën pjesë ekipe nga gjashtë vende të Ballkanit Perëndimor, Shqipëria, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Bosnje-Hercegovina dhe Serbia, me qëllim forcimin e bashkëpunimit rajonal dhe rritjen e gatishmërisë ndaj kërcënimeve kibernetike.

Stërvitja synon të ndërtojë një kuadër të përbashkët për reagim dhe menaxhim të incidenteve kibernetike, duke thelluar bashkëpunimin midis institucioneve të sigurisë dhe teknologjisë



së vendeve pjesëmarrëse.

Një eksperiencë e vlefshme për ndarjen e njohurive dhe forcimin e sigurisë kibernetike në rajon, ku ekipi shqiptar përfaqësoi me profesionalizëm dhe përkushtim kapacitetet kombëtare në fushën e mbrojtjes digjitale.

STAFI

ANJEZA MUSOLLARI
Shefe e Sektorit të
Botimeve & Kryeredaktor

Redaktore/ korrektore:
Suela HODA

Graphic Designer:
Afërdita HYSAJ

ADRESA:
Rruga e Dibrës/
Garnizoni “Skënderbej”

Qeveria shqiptare ka miratuar Aktin Normativ që rishikon dhe përforcon Buxhetin e Mbrojtjes për vitin 2025, duke vendosur theks të veçantë në forcimin e kapitalit njerëzor, rritjen e kapaciteteve operacionale dhe nisjen e prodhimit të armatimit, mjeteve dhe pajisjeve ushtarake me markën “Made in Albania”.



Ky akt strategjik, i iniciuar nga Ministria e Mbrojtjes, synon të përshpejtojë proceset e modernizimit të Forcave të Armatosura, në përputhje me standardet e NATO-s dhe nevojat e sigurisë kombëtare në një mjedis të sigurisë që po ndryshon me ritme të shpejta.

Fokus në kapitalin njerëzor dhe stërvitjen profesionale

Një nga shtyllat kryesore të Aktit Normativ është forcimi i kapitalit njerëzor. Parashikohet rritje e ndjeshme e investimeve në trajnime, programe arsimore ushtarake dhe kushte më të mira pune për personelin aktiv, rezervistët dhe rekrutët e rinj.

Ky investim synon jo vetëm të rrisë profesionalizmin dhe qëndrueshmërinë e trupës ushtarake, por edhe ta bëjë shërbimin ushtarak më tërheqës për brezat e rinj.

“Made in Albania”, prodhimi vendas ushtarak bëhet realitet

Në kuadër të këtij akti, Ministria e Mbrojtjes do të nisë fazën e parë të prodhimit vendas të armatimit, mjeteve dhe pajisjeve ushtarake, duke krijuar bazat për një industri të qëndrueshme mbrojtëse shqiptare.

Ky projekt kombëtar synon



Akti Normativ i Buxhetit 2025 forcon mbështetjen për Mbrojtjen Kombëtare: “Made in Albania” në qendër të zhvillimit ushtarak

të reduktojë varësinë nga importet, të zhvillojë aftësi teknologjike vendase dhe të gjenerojë vende të reja pune në sektorin e mbrojtjes dhe industrisë së rëndë.

Përmes partneriteteve publike dhe private, pritet të krijohen linja prodhimi për pajisje logjistike, armë të lehta, sisteme komunikimi dhe mjete të blinduara të përshtatura për terrenin shqiptar.

si prioritet garantimin e një rrjeti të integruar logjistik e komunikimi, që rrit gatishmërinë dhe ndërveprimin me aleatët e NATO-s.



Investime në infrastrukturën kritike të mbrojtjes

Një tjetër komponent i rëndësishëm i Aktit Normativ është financimi i projekteve për modernizimin e infrastrukturës kritike: bazat ajrore dhe detare, qendrat e komandimit dhe trajnimit, si dhe sistemet e sigurisë kibernetike.

Në këtë kuadër, Ministria e Mbrojtjes ka përcaktuar



Qëndrueshmëri dhe vizion afatgjatë

Ministri i Mbrojtjes ka theksuar se ky Akt Normativ është “një hap i rëndësishëm drejt vetë-qëndrueshmërisë së kapaciteteve tona mbrojtëse dhe zhvillimit të potencialit njerëzor e teknologjik vendas”.

“Përmes këtij akti, ne po hedhim themelet e një ushtrie moderne, të aftë të prodhojë, të mbrojë dhe të ndërtojë të ardhmen e sigurt të vendit tonë”, - është shprehur ai.

Ky rishikim buxhetor reflekton një qasje të re ndaj sigurisë kombëtare, ku bashkohen vizioni ekonomik, inovacioni teknologjik dhe përkushtimi ndaj mbrojtjes së territorit dhe sovranitetit të Shqipërisë.

Ekipi drejtues i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, i kryesuar nga Drejtori i Shtabit, gjeneral brigade Ardian Lilo, përmbylli një vizitë zyrtare në Republikën e Kosovës.

Gjatë kësaj vizite, u zhvilluan takime me drejtues të lartë të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) dhe të institucioneve të tjera të mbrojtjes, ku në qendër të diskutimeve ishte forcimi i marrëdhënieve dypalëshe ushtarake, shkëmbimi i përvojave profesionale dhe koordinimi i aktiviteteve të përbashkëta në planin afatmesëm dhe afatgjatë.

Qëllimi kryesor i vizitës ishte rritja e kapaciteteve operacionale, bashkëpunimi në fushën e trajnimeve dhe stërvitjeve të përbashkëta, si dhe përmirësimi i ndërveprueshmërisë mes dy forcave në kuadër të përbashkimit të



FORCAT E ARMATOSURA DHE FSK FORCOJNË BASHKËPUNIMIN STRATEGJIK

Forcimi i bashkëpunimit ushtarak Shqipëri–Kosovë

Drejtimesit e Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, zhvillojnë vizitë zyrtare në Kosovë



sfidave të sigurisë në rajon dhe më gjerë.

Të dyja palët riafirmuan angazhimin për të vazhduar bashkëpunimin e ngushtë në funksion të paqes, stabilitetit dhe sigurisë rajonale, duke vlerësuar lart marrëdhëniet tradicionale vëllazërore mes dy shteteve.

Batalioni i Xhenios garanton sigurinë publike përmes pastrimit të zonave nga municionet e rrezikshme

Ekspertët e Njesisë EOD (Explosive Ordnance Disposal) të Batalionit të Xhenios, janë angazhuar në operacione pastrimi dhe asgjësimi të municioneve të rrezikshme në bashkitë Durrës dhe Himarë, pas kërkesës së autoriteteve civile lokale.

Në këtë ndërhyrje, ekipet e specializuara të EOD kanë kryer identifikimin, vlerësimin dhe asgjësimin e municioneve luftarake të paplasura, duke garantuar sigurinë e banorëve dhe parandalimin e rrezikut të shpërthimeve të mundshme.

Operacionet janë zhvilluar me standardet më të larta të sigurisë dhe profesionalizmit, duke demonstruar gatishmërinë e Forcave të Armatosura për t'u përgjigjur menjëherë çdo situatë që lidhet me rrezikun nga municionet e mbetura.



Efektivët e Batalionit të Xhenios vijnë të përbushin me përkushtim dhe përgjegjësi detyrat jetike për sigurinë publike, duke dhënë kontribut të rëndësishëm në mbrojtjen e jetës dhe mjedisit në mbarë territorin e vendit.






BATALIONI I KËMBËSORISË SË
LEHTË NË MARSHIMIN TAKTIK



STËRVITJA "FIRE PHOBIA"





Akademia e Nënoficerëve “Thomson”, Tradita dhe Rruga e Formimit të “Shtyllës Kurrizore” të Ushtrisë Shqiptare

Nga themelimi i parë i shkollave të nënoficerëve, në vitin 1919, deri te Akademia bashkëkohore e Arsimit Profesional të Nënoficerëve – një histori përkushtimi, profesionalizmi dhe përparimi në shërbim të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Hyrje historike dhe themelimi i traditës

Nënoficeri, i quajtur me të drejtë “shtylla kurrizore e ushtrisë”, ka zënë gjithmonë një vend qendror në historinë dhe strukturën e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Përkushtimi, disiplina, profesionalizmi dhe roli i tij udhëheqës në menaxhimin e trupës ushtarake e kanë bërë atë një figurë të pazëvendësueshme në çdo etapë të zhvillimit të ushtrisë sonë.

Trajnimi i trupës së nënoficerëve në Shqipëri ka një histori të gjatë e të ndritur që nis në vitin 1919, kur u hapën për herë të parë shkollat dhe kurset për nënoficerë. Këto institucione vazhduan aktivitetin e tyre deri në prag të Luftës së Dytë Botërore, duke

përgatitur breza të tërë nënoficerësh, të cilët luajtën një rol vendimtar në strukturat e sigurisë kombëtare dhe mbrojtjes së vendit.

Në këtë kontekst historik, më datë 5 nëntor 1993, me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes, u krijua Akademia e Nënoficerëve, si një domosdoshmëri e kohës për rikthimin e traditës së përgatitjes së përqendruar dhe profesionale të nënoficerëve të karrierës. Ky institucion përfaqësonte një kthesë të madhe në procesin e demokratizimit dhe profesionalizimit të Forcave të Armatosura, duke

i dhënë një frymë të re sistemit të arsimit ushtarak në Shqipëri.

Nga fillesat te konsolidimi i shkollave të para të nënoficerëve (1919–1965)

Periudha pas shpalljes së Pavarësisë u shënuar nga përpjekje të vazhdueshme për ndërtimin e institucioneve kombëtare të mbrojtjes dhe sigurisë. Në këtë kuadër, u krijuan strukturat e para për





arsimimin e trupës së nënoficerëve:

- Viti 1919: u hapën shkollat e xhandarmërisë dhe aspirantëve për nënoficerë, duke vendosur themelet e para të arsimit ushtarak profesional.
- Viti 1925: në Durrës u hap Shkolla e Nënoficerëve, me një kurs 6-mujor që zhvillohej çdo vit.
- Viti 1929: u themelua Shkolla e Nënoficerëve për këmbësori, artileri dhe xhenio, duke zgjeruar fushat e specializimit.
- Viti 1931: u ngrit Shkolla e Perfeksionimit të Nënoficerëve në Durrës, e cila përzgjidhte kandidatë nga ushtria dhe i kualifikonte për karrierë të qëndrueshme.

Në periudhën 1950–1965, në komandat përkatëse u zhvilluan kurse të ndryshme të shërbimit për nënoficerë. Në këtë kohë u ngrit edhe Shkolla e Intendencës, e cila më parë njihej si Shkolla e Prapavijës. Kjo periudhë shënoi një përpjekje të re për organizimin dhe sistematizimin e përgatitjes së personelit të mesëm ushtarak.

Megjithatë, pas viteve ’60, me heqjen e gradave, roli i nënoficerit u zvogëlua ndjeshëm dhe numri i tyre ra, duke sjellë nevojën për ristrukturim të sistemit në dekadat që pasuan.

Rilindja e sistemit dhe themelimi i Akademisë së Nënoficerëve ‘Thomson’ (1993–2003)

Ristrukturimi i ushtrisë shqiptare pas viteve ’90 kërkonte një qasje të re në arsimimin ushtarak. Demokratizimi i shoqërisë dhe orientimi drejt standardeve euroatlantike e bënë të domosdoshme ringritjen e një institucioni të specializuar për përgatitjen e nënoficerëve të karrierës.

Kështu, më 5 nëntor 1993, mbi bazën e Shkollës së Instruksionit në Zall-Herr, u themelua Akademia e Nënoficerëve.

Më vitin 2003, me vendim të Qeverisë Shqiptare, Akademisë iu akordua emri i kolonelit holandez Ludowik Thomson, në nderim të figurës së tij historike dhe kontributit që ai dha për organizimin e trupës ushtarake shqiptare në vitet 1911–1915. Kështu, institucionit iu dha emri zyrtar “Akademia e Nënoficerëve ‘Thomson’”, si shenjë e respektit dhe mirënjohjes për një figurë që ra në krye të detyrës në tokën shqiptare.

Misioni i këtij institucioni u përkufizua qartë: “Formimi, kualifikimi dhe përgatitja e nënoficerëve të të gjitha niveleve në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.

Struktura akademike dhe nivelet e arsimit në QAPN (ANO)

Në përputhje me transformimet moderne të Forcave të Armatosura, Qendra e Arsimit Profesional të Nënoficerëve (QAPN) është struktura bazë ku zhvillohet arsimi profesional për këtë kategori.

Ky sistem arsimor është i ndarë në kurse institucionale dhe kurse funksionale, të cilat sigurojnë zhvillimin gradual të karrierës së çdo nënoficeri.

KURSET INSTITUCIONALE:

- Kursi Fillestar i Nënoficerit (KFNO) – 5 javë në QAPN.
- Kursi Bazë i Nënoficerit (KBNO) – 16 javë (8 javë leadership + 8 javë specialitet).
- Kursi i Avancuar i Nënoficerit (KANO) – 16 javë (po ashtu në dy faza).
- Kursi i Lartë i Nënoficerit (KLNO) – 8 javë.
- Kursi i Kryekapterit (KKK) – 8 javë.

KURSET FUNKSIONALE:

Kursi i Instruktorit të Stërvitjes – 3 javë.
Kursi i Administratës së Mesme Civile – 2 javë.

Këto programe kanë për qëllim zhvillimin e leadershipit, menaxhimit ushtarak, disiplinës dhe përgatitjes teknike në nivel grupi, toge e njësie, duke i përgatitur nënoficerët për përgjegjësi të larta drejtuese dhe këshilluese në strukturat e FA-së.

Përzgjedhja, kriteret dhe bashkëpunimi ndërkombëtar

Përzgjedhja e kandidatëve për ndjekjen e kurseve në Akademinë e Nënoficerëve kryhet sipas kriterëve të përcaktuara në Ligjin nr. 59/2014 dhe Udhëzimin nr. 03, datë 18.02.2016 të Ministrit të Mbrojtjes. Në procesin e konkurrimit përfshihen testime intelektuale, fizike, psikologjike, mjekësore dhe të njohurive në gjuhën angleze, si dhe vlerësimi i titujve të meritës.

Në këtë mënyrë, sigurohet një standard i lartë profesional dhe përzgjedhje meritokratike që garanton cilësi në strukturat drejtuese të Forcave të Armatosura.

Një element i rëndësishëm i zhvillimit të ANO-së ka qenë bashkëpunimi me vendet aleate të NATO-s, veçanërisht me Gardën Kombëtare të New Jersey-it (SHBA). Ky partneritet ka ndikuar

ndjeshëm në përmirësimin e metodave të mësimdhënies, në harmonizimin e programeve mësimore me standardet e STANAG dhe në ngritjen e nivelit profesional të trupës instruktore.

Sot, i gjithë procesi mësimor në QAPN zhvillohet nga vetë nënoficerët – dëshmi e një niveli të lartë profesionalizmi, përkushtimi dhe pjekurie institucionale.

Roli bashkëkohor dhe vizioni i ardhshëm

Në kuadrin e transformimeve që kanë përfshirë Forcat e Armatosura pas anëtarësimit në NATO, Akademia e Nënoficerëve “Thomson” ka mbetur një shtyllë themelore e sistemit arsimor ushtarak shqiptar.

Kjo qendër është përgjegjëse për kualifikimin e gjithë trupës së nënoficerëve dhe personelit të mesëm civil, duke garantuar një zinxhir profesional të qëndrueshëm në të gjitha nivelet e komandimit.

Në një ushtri moderne, ku profesionalizmi, leadershipi dhe ekspertiza janë parime thelbësore, nënoficeri mbetet faktori kryesor që lidh konceptin strategjik me zbatimin praktik. Ai është edukator, drejtues, menaxher dhe bashkëpunëtor i pandashëm i komandantit në çdo repart apo mision.

Akademia e Nënoficerëve “Thomson” nuk është vetëm një institucion arsimor, por një vatër tradite, përkushtimi dhe përparimi profesional, që pasqyron historinë dhe zhvillimin e Forcave të Armatosura Shqiptare. Siç dëshmon rrugëtimi mbi një shekull, ky institucion ka ndërtuar dhe formuar breza nënoficerësh që kanë mbrojtur me dinjitet dhe nder emblemën e Ushtrisë Shqiptare, duke ecur përpara me devizën:

“Nënoficeri – Forcë, Disiplinë dhe Profesionalizëm në Shërbim të Atdheut.”





ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Rrugëtimi që forcon karakterin, hapat që çojnë drejt nderit

Në çdo mëngjes ushtarak, kur zëri i trombës zgjon repartet dhe rreshtat mbushen me hapa të sinkronizuar, në atë ritëm të rregullt fshihet një mësim i lashtë, që vlen jo vetëm për uniformën, por për jetën: para se të vraposh, mëso të ecësh.

Kjo shprehje e thjeshtë përmbledh filozofinë e përgatitjes, durimit dhe përlësisë, tri shtylla që mbajnë në këmbë jo vetëm formimin ushtarak, por edhe njeriun në çdo fushë të jetës.

Ngjitja pa shkallë, tundimi i epokës moderne

Jetojmë në një kohë ku gjithçka kërkohet me shpejtësi: sukses, famë, fitim, pozicion. Është epoka e rezultateve të menjëhershme, e rrjeteve sociale, e imazhit, e dukjes. Por në këtë nxitim të përbotshëm, po harrohet diçka thelbësore: ‘procesi’. Gjithnjë e më shpesh, shihen individë që kërkojnë të arrijnë majën e “piramidës” pa kaluar shkallët e saj. Disa duan të jenë ‘komandantë’ pa qenë më parë ‘ushtarë’. Të tjerë kërkojnë të udhëheqin pa mësuar si të dëgjojnë.

Në jetën ushtarake, kjo logjikë është e rrezikshme. Sepse çdo gradë, çdo detyrë, çdo mision ndërtohet mbi përvojë dhe sakrificë. Një oficer që nuk ka njohur terrenin, që nuk ka kaluar nëpër stërvitje, që nuk ka ndier peshën e përgjegjësisë, nuk mund të udhëheqë me efikasitet. Ashtu siç një ndërtesë pa themele nuk reziston, po ashtu një karrierë e ndërtuar me nxitim shembet në përballje me sfidat e para.

Disiplina, themeli i ecjes së qëndrueshme

Disiplina është ajo që dallon një grup njerëzish nga një trup i organizuar ushtarak. Ajo është forca e padukshme që e bën çdo hap të ketë ritëm, çdo veprim të ketë kuptim. Por disiplina nuk lind në një ditë; ajo mësohet, ndërtohet dhe forcohet çdo ditë përmes ushtrimeve, respektit dhe vetëkontrollit.

Instruktorët stërvitorë, ushtarakë me një karrierë të gjatë në Forcat e Armatosura shprehen se: “Shumë rekrutë të rinj vijnë me dëshirën për t’u dalluar që në javën e parë. Duan të tregojnë se janë më të shpejtë, më të zotë. Por kur u themi se në ushtri suksesi nuk matet me shpejtësi, por me saktësi, në fillim habiten. Pastaj, kur kalojnë muajt e parë, e kuptojnë se ecja e sigurt vlen më shumë se vrap i pamenduar”.

Disiplina është arti për të kuptuar se çdo hap ka një qëllim. Ajo të mëson se para se të bëhesh udhëheqës, duhet të jesh ndjekës i mirë; para se të japësh urdhra, duhet të mësosh të zbatosh urdhrat me korrektësi.

Durimi, arma që nuk duket, por fiton beteja

Durimi është një nga virtytet më të vështira për t’u zotëruar. Ai nuk shihet në paradë, nuk matet me medalje, por ndjehet në çdo moment stërvitjeje, në çdo natë roje, në çdo orë pritjeje. Në fushëbetejë, durimi është shpesh ndryshimi midis suksesit dhe dështimit.

Në një stërvitje të zhvilluar në Qendrën e Stërvitjes në Bizë,

“NË JETËN USHTARAKE, KJO LOGJIKË ËSHTË E RREZIKSHME. SEPSE ÇDO GRADË, ÇDO DETYRË, ÇDO MISION NDËRTOHET MBI PËRVOJË DHE SAKRIFICË. NJË OFICER QË NUK KA NJOHUR TERRENIN, QË NUK KA KALUAR NËPËR STËRVITJE, QË NUK KA NDIER PESHËN E PËRGJEGJËSISË, NUK MUND TË UDHËHEQË ME EFIKASITET. ASHTU SIÇ NJË NDËRTESE PA THEMELE NUK REZISTON, PO ASHTU NJË KARRIERË E NDËRTUAR ME NXITIM SHEMBET NË PËRBALLJE ME SFIDAT E PARA.

një grup rekrutësh të rinj e mësuan këtë mësim në mënyrën më të drejtpërdrejtë. Në ditën e parë, shumë u lodhën pas disa kilometrash marshim. Disa menduan të dorëzohen. Por instruktorët nuk i qortuan, i lanë të kuptonin vetë se forca fizike pa durim është e kotë. Pas disa ditësh, të njëjtët rekrutë jo vetëm që përfunduan marshimin, por e bënë me buzëqeshje. Kishin mësuar të ecnin me ritmin e trupit dhe mendjes. Kishin kuptuar se durimi është arma e vërtetë e ushtarit.

Shkallët e formimit, nga rekrut në lider

Çdo ushtar, çdo oficer, çdo komandant ka një histori që nis me hapin e parë.

Shkallët e formimit janë si provat e jetës: nuk mund të anashkalohen.

Në Akademinë e Forcave të Armatosura, kadetët kalojnë vite të tëra përgatitjeje, ku çdo modul, çdo detyrë, çdo vlerësim është pjesë e rrugës drejt pjekurisë profesionale. Ata mësojnë se lidershipi nuk është titull, por përgjegjësi; nuk është autoritet, por shembull.

Një kadet që nuk di të ecë në harmoni me grupin e tij, nuk mund të udhëheqë asnjë ditë në fushë. Sepse udhëheqja e vërtetë fillon me aftësinë për të ecur bashkë me të tjerët.

Pedagogë të Akademisë së Forcave të Armatosura thonë: “Në çdo brez të ri, shohim dëshirën për të dalë përpara. Por detyra jonë është t’u mësojmë se nuk ka përpara pa themel. Një oficer që ka mësuar të ecë me përlësi, do të dijë të udhëheqë me urtësi”.

Vlera që lind nga procesi

Ecja është proces. Dhe çdo proces kërkon kohë, përkushtim dhe qëndrueshmëri.

Para se të vraposh, mëso të ecësh! Udhëtimi drejt majës fillon me hapin e parë

Në ushtri, asgjë nuk mësohet për një ditë, as qëndrimi, as shërbimi, as përkushtimi. Por kur këto vlera formohen, ato qëndrojnë gjatë gjithë jetës.

Pikërisht për këtë, ushtarët që kanë kaluar nëpër procesin e stërvitjes e dinë sa e rëndësishme është të ndërtosh bazën para se të kërlesh majën. Ky parim vlen për çdo profesion, për çdo fushë, për çdo njeri.

Në shoqërinë shqiptare të sotme, shpesh ndeshemi me figura që kërkojnë të duken të realizuara pa e kaluar rrugën e vështirë të përpjekjes. Kjo prirej nuk sjell zhvillim, por brishtësi. Sepse suksesi që nuk buron nga procesi është si uniforma pa përmbajtje: mund të duket mirë nga jashtë, por nuk mbart peshën e vërtetë të përvojës.

Shpejtësia që vret përkushtimin

Shpesh themi se jetojmë në “epokën e shpejtësisë”. Por në ushtri, çdo lëvizje e shpejtë pa përgatitje është rrezik. Një vendim i nxituar në terren mund të sjellë pasoja të pariparueshme. Një plan i pabazuar në përvojë mund të dështojë edhe përpara se të fillojë. Për këtë arsye, formimi ushtarak është gradual: ecje e sigurt drejt perfeksionit. Në këtë proces, çdo hap ka vlerë. Çdo ditë stërvitjeje është një gur më shumë në themelin e profesionalizmit.

Nga ecja individuale tek ecja në formacion

Një nga mësimet më të thella që ofron ushtria është se forca nuk qëndron tek individ, por tek kolektivi. Ecja në formacion nuk është thjesht një manovër fizike — është simbol i bashkimit, koordinimit dhe përgjegjësisë së ndërsjellë.

Kur një repart ecën me ritëm të njëjtë, çdo ushtar kupton se nuk është vetëm; se forca e tij varet nga ritmi i tjetrit.

Në këtë kuptim, të mësosh të ecësh nuk është vetëm proces personal — është mësim për bashkëpunim, respekt dhe solidaritet. Sepse askush nuk mund të vrapojë i vetëm drejt suksesit në një organizatë që kërkon unitet.

Mësimi që mbetet

“Para se të vraposh, mëso të ecësh” nuk është thjesht një këshillë, por një mënyrë të menduari. Në çdo fazë të jetës ushtarake — nga rekrutimi, në karrierë, në komandim — ky parim rikthehet si busull që të kujton se suksesi kërkon durim. Në një kohë ku shumë njerëz kërkojnë rezultat pa mund, është detyrë e çdo institucioni, e çdo instruktori, e çdo oficeri të kujtojë këtë vlerë themelore. Sepse vetëm nëpërmjet ecjes së qëndrueshme ndërtohen karakteret e forta, lidershipi i vërtetë dhe profesionalizmi që i shërben atdheut me nder.

Ecja si metaforë e jetës ushtarake

Në fund, gjithçka kthehet tek thelbi: ecja është më shumë se lëvizje fizike — është simbol i përgatitjes, i maturisë dhe i besimit në proces.

Ashtu si ushtari që fillon me hapin e parë përpara, edhe njeriu duhet të pranojë se çdo arritje kërkon kohën e vet. Nuk mund të vraposh drejt qëllimit nëse nuk ke ndërtuar ekuilibrin për ta mbajtur ritmin. Dhe kur mëson të ecësh drejt, çdo vrap, çdo sfidë, çdo majë bëhet e arritshme.

Ai që mëson të ecë me përlësi, do të dijë të vrapojë me dinjitet.

Fëmijëria dhe formimi i hershëm

Në qytetin e Elbasanit, më 4 shtator të vitit 1965, lindi një djalë që do të shënonte gjurmë të rëndësishme në historinë moderne të Forcave Detare shqiptare, Edmond Zhupani. Që në moshë të vogël, ai u dallua për seriozitet, përkushtim dhe ndjenjë të thellë atdhetarie. Shkollën tetëvjeçare e kreu në qytetin e lindjes me rezultate të shkëlqyera, duke dëshmuar se ishte i destinuar për rrugë të veçantë në shërbim të kombit.

Në vitin 1979, pas një procesi përzgjedhjeje të rreptë, ai fitoi të drejtën për të ndjekur Shkollën e Mesme të Përgjithshme Ushtarake “Skënderbej”, e cila njihej si vatra më prestigjioze e formimit të brezave të rinj ushtarakë shqiptarë. Në bankat e kësaj shkolle, në periudhën 1979-1983, Zhupani jo vetëm që shfaqti aftësi të shkëlqyera akademike, por u dallua edhe për disiplinë, frymë kolektive dhe ndjenjë të lartë përgjegjësie, vlera që do ta shoqëronin në gjithë karrierën e tij.

Rruga drejt Marinës, diplomimi dhe hapat e parë në det

Pas përfundimit të studimeve në “Skënderbej”, i riu nga Elbasani fitoi të drejtën e studimeve në Shkollën e Lartë të Marinës në Vlorë, ku u përgatit për t’u bërë oficer aktiv i Forcave Detare. Në këtë institucion të rëndësishëm të arsimit ushtarak, gjatë viteve 1983-1987, ai u shqua për njohuritë e thella teorike, përgatitjen tekniko-profesionale dhe për zotërimin e shkëlqyer të disiplinave detare. Në përfundim të studimeve, Edmond Zhupani u diplomua me rezultate të larta dhe mori gradën e oficerit aktiv, duke filluar menjëherë punën në strukturat e Flotës Luftarake Detare (FLD).

Karriera e hershme dhe ngritja në detyrë

Në periudhën 1987-1990, ai shërbeu si Komandant i Organit të Drejtimit (OL) në Vlorë, ku fitoi përvojën e parë konkrete në drejtim dhe komandim detar.

Falë aftësive të tij organizative, ndershmërisë profesionale dhe lidërshiptit të balancuar, Zhupani fitoi respektin e bashkëpunëtorëve dhe vartësve.

Në shtator të vitit 1990, ai u emërua pedagog në Akademinë Detare, ku për tre vjet (1990-1993) dha një kontribut të çmuar në përgatitjen e brezave të rinj të oficerëve detarë. Ishte periudha e ndryshimeve të mëdha në Shqipëri, dhe pedagogë si Zhupani përfaqësonin modelin e oficerit profesionist, të aftë të përshtateshin me realitetin e ri institucional dhe ushtarak të vendit.

Komandant i Flotës Luftarake Detare

Në qershor të vitit 1993, Edmond Zhupani u ngarkua për herë të parë me detyrën më të lartë në strukturat detare shqiptare, Komandant i Flotës Luftarake Detare të Shqipërisë, me gradën “kundëradmiral”. Emërimi i tij në këtë detyrë përbënte një moment të rëndësishëm për FLD-në, pasi shënonte ardhjen në krye të një kuadri të ri, të formuar në realitetet pas-komuniste, por me bazë të fortë akademike e profesionale.

Nën drejtimin e tij, u ndërmorën reforma të rëndësishme në ristrukturimin e njësive detare, në modernizimin e bazave logjistike dhe në forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar të flotës. Kundëradmiral Zhupani i kushtoi vëmendje të veçantë përgatitjes teknike të ekuipazheve, disiplinës, dhe përmirësimit të standardeve të sigurisë në det.

Në periudhën 1994-1996, ai vijoi formimin e tij akademik në Gjermani, ku ndoqi studimet e larta ushtarake në kuadër të bashkëpunimeve dypalëshe në fushën e mbrojtjes. Përvoja në akademitë gjermane i dha atij një horizont të ri strategjik, duke i mundësuar të aplikonte në Shqipëri konceptet bashkëkohore të drejtimit dhe menaxhimit të flotës.

Pas kthimit, në vitin 1996, ai u rikthye sërish në detyrën e

Kundëradmiral Edmond Zhupani, Skënderbegasi që udhëhoqi Flotën Luftarake Detare të Shqipërisë



Kundëradmiral
Edmond Zhupani

Komandantit të Flotës Luftarake Detare, për herë të dytë, duke e mbajtur këtë post deri në maj të vitit 1997.

Kundëradmirali që la gjurmë

Në karrierën e tij, Zhupani u shqua për integritet profesional, vendosmëri, dhe dashuri për detin. Ai i përkiste brezit të oficerëve që përfaqësonin një ndërthurje të brezit të vjetër të formuar në rregulla të hekurt ushtarake me modelin e ri të drejtimit modern e demokratik. Nën komandën e tij, FLD ruajti kohezionin institucional dhe profesionalizmin, në një periudhë të vështirë për vendin, kur forcat e armatosura po përballeshin me transformime të thella pas vitit 1991.

Trashëgimia dhe vlerësimi historik

Në radhën e komandantëve të Flotës Luftarake Detare të Shqipërisë, Kundëradmiral Edmond Zhupani renditet ndër drejtuesit më të përgatitur profesionalisht dhe më të respektuar. Ai ishte ndër të paktët që e drejtoi FLD-në dy herë, në periudha të ndryshme, ashtu si më herët Kundëradmiral Abdi Mati, një tjetër figurë e shquar e flotës shqiptare.

Lista historike e komandantëve të FLD-së është një pasqyrë e rrugëtimit të forcave tona detare që nga krijimi i tyre: Kapidan Ahmet Kapidani (1928-1939); Kundëradmiral Abdi Mati (1945-1957, 1961-1973); Kundëradmiral Teme Seiko (1958-1960); Kundëradmiral Hito Çako (1960-1961); Qamil Poda (1973-1981); Ndue Jaku (1981-1991); Kapiten i Rangut I Tasim Meçe (1991-1992); Kapiten i Rangut I Fitim Halili (1992-1993); Kundëradmiral Edmond Zhupani (1993-1994, 1996-1997); Kundëradmiral

Muharrem Kuçana (1994-1996); Kapiten i Rangut I Vladimir Beja (1997); Kapiten i Rangut I Robert Bali (1997-1998); Kundëradmiral Kudret Çela (1998-2005, 2009-2012); Kapiten i Rangut I Kristaq Gërveni (2005-2009); Kapiten i Rangut I Ferdinand Kreshpani (2012); dhe Gjeneral Brigade Qemal Shkurti (2012-2015).

Në këtë radhë të lavdishme, emri i Kundëradmiral Zhupanit mbetet sinonim i përkushtimit, profesionalizmit dhe drejtimit me dinjitet.

Një jetë në shërbim të detit dhe atdheut

Figura e tij përfaqëson një brez oficerësh që e panë detin jo vetëm si hapësirë shërbimi, por si një ideal për të cilin ia vlen të punosh me pasion dhe përkushtim. Disiplina e hekurt, ndershmëria profesionale dhe respekti për vartësit janë tre shtylla që e përkufizojnë portretin e tij njerëzor e ushtarak.

Në radhët e kolegëve dhe ish-vartësve, ai kujtohet si komandant i drejtë dhe i matur, që e njihte çdo detaj të strukturës që drejtonte dhe i qëndronte besnik parimit: “Detari nuk e njeh lodhjen kur mbron flamurin.”

Sot, kur historia e Forcave Detare Shqiptare po pasurohet me kapituj të rinj në kuadër të bashkëpunimit euroatlantik, kujtimi i figurave si Kundëradmiral Edmond Zhupani mbetet një pikë referimi për profesionalizmin dhe përkushtimin ndaj detyrës. Ai është pjesë e asaj plejade ushtarakësh që ndërtuan themelet e Marinës shqiptare moderne – me dije, me sakrificë dhe me dashuri të pakushtëzuar për Atdheun.

Përgatiti Redaksia e gazetës “Ushtria”



KOLONEL HYSNI GJERGJI

Lufta hibride nuk synon të pushtojë tokë, por mendje

Sot armiku nuk po vjen më me uniformë, por me lajme, me rrjete sociale, me premtime dhe narrative të rreme. Detyra jonë si ekspertë të sigurisë, por edhe e secilit ushtarak, është që të njohim qëllimin në fytyrën e kundërshtarit madje edhe kur ai buzëqesh. Aktualisht luftërat nuk po zhvillohen më vetëm me tanke e armë.

Ato ndodhin në heshtje, në ekrane, në rrjete sociale, në ekonomi dhe në shoqëri. Rusia, si shteti më agresor deri në 2025, e cila është e izoluar ndërkombëtarisht dhe e përfshirë në një përplasje të hapur me Perëndimin, po i zgjeron frontet e saj të padukshme në çdo vend europian.

Moska zyrtare aktualisht përdor fushata të dezinformimit për të ulur besimin te NATO, me qëllimin final për të krijuar përçarje midis vendeve anëtare. Kërcënimi rus nuk është më hipotetik, ai është real, i vazhdueshëm dhe i sofistikuar për t'u zbuluar. Për t'u përballur me të edhe Shqipëria me FA-të duhet të forcojë bashkëpunimin me aleatët, të rrisë kapacitetet e inteligjencës dhe sigurisë kibernetike dhe mbi të gjitha, të mbajë të fortë unitetin e saj kombëtar dhe moralin e trupave të saj. Vetëm një ushtri e informuar është një ushtri e pathyeshme dhe informacioni është mburoja e parë kundër armikut të padukshëm.



LUFTA MODERNE SOT ËSHTË NJË STRATEGJI QË KOMBINON PRESIONIN USHTARAK DHE DIPLOMATIK, PROPAGANDËN DHE DEZINFORMIMIN, ME NDIKIMIN EKONOMIK E KULTUROR, SI DHE SPIUNAZHIN E SABOTAZHIN. PËRGJATË VITIT 2025 POR EDHE MË PARË, DISA ANALISTË TË SIGURISË SUGJEROJNË SE NJË FORMË MODERNE E KËSAJ TAKTIKE, MUND TË JETË AKTIVITETI I RRJETEVE TË NDIKIMIT, DEZINFORMIMIT, OSE TË INFILTRIMIT NË STRUKTURA TË NDRYSHME POLITIKE, EKONOMIKE APO TEKNOLOGJIKE.

Ka disa indikatorë, të cilët ekspertët e inteligjencës perëndimore i konsiderojnë si tregues të aktivizimit të operacioneve të orkestruara nga ana e Rusisë në Evropë ose SHBA-së. Përdorimi i çështjeve të brendshme me mundësi përçarje sociale, si emigracioni, papunësia, ankesat ndaj elitës politike etj., përdoren nga Rusia për të nxitur polaritet, përçarje ose mosbesim. Janë evidentuar akte sabotazhi, përveç spiunazhit klasik, me sulme kibernetike, ndërhyrje në infrastrukturë kritike, përdorim dronësh, ose persona që nuk duken si agentë të klasit “këshilltar”, por si elementë që aktivizohet në kohë krize.

Në këtë sfond, Shqipëria si shtet Ballkanik, si anëtare e NATO-s dhe partnere strategjike e Shteteve të Bashkuara, nuk është përjashtim. Lufta moderne sot është një strategji që kombinon presionin ushtarak dhe diplomatik, propagandën dhe dezinformimin, me ndikimin ekonomik e kulturor, si dhe spiunazhin e

sabotazhin. Përgjatë vitit 2025 por edhe më parë, disa analistë të sigurisë sugjerojnë se një formë moderne e kësaj taktike, mund të jetë aktiviteti i rrjeteve të ndikimit, dezinformimit, ose të infiltrimit në struktura të ndryshme politike, ekonomike apo teknologjike.

Aktivizimi i “agentëve të fjetur” klasikë (persona që jetojnë për vite në vende perëndimore pa veprim derisa të marrin urdhër) është i mundshëm, por më pak i mundur sesa më parë, sepse shërbimet e inteligjencës perëndimore janë shumë më vigjilente tani dhe teknologjia e mbikëqyrjes e bën më të vështirë operimin e tillë. Megjithatë, “agentët e ndikimit”, të cilët janë persona ose organizata që përhapin narrativa pro-ruse, ndikojnë në opinionin publik ose politik, janë shumë më aktivë sot dhe mund të konsiderohen një version modern i “agentëve të fjetur”. Ka mundësi që Rusia të ketë ende rrjete të fjetura në Perëndim, por më e mundshme është që “aktivizimi” të ndodhë përmes ndikimit,

mediave sociale, ekonomisë dhe politikës, jo aq përmes spiunazhit klasik.

Ka raporte të botuar në mediat vendase dhe mediat prestigjioze perëndimore nga Letonia, se Rusia ka rritur operacionet e sabotazhit dhe ndikimit në vendet baltike. Një analizë e botuar tregon për “agjentë të fjetur” ose sabotues që përdorin dronë ose veprime në aeroporte për të krijuar frikë, mosbesim ose çorientim. Përdorimi i mediave sociale, krijimi i faqeve fake, blerja e ndikimeve politike, bëhet për të përhapur narrative që shkojnë në favor të Rusisë ose kundër interesave perëndimore. Rrjeti i dezinformimit “Doppelgänger” ka kopjuar faqe lajmesh dhe i ka përdorur për të shpërndarë përmbajtje pro-ruse në Francë dhe Gjermani. Rasti i organizatës “Pravfond”, sipas “The Guardian”, supozohet të jetë një fondacion me lidhje ruse që vepron në 48 vende dhe merret vetëm me fushata propagande. Aktualisht nuk përdoren më vetëm diplomatë të mbuluar ose agjentë të profilit të lartë. Aktualisht

Moska përdor persona të zakonshëm me punë të përditshme, që mund të aktivizohen në momentin vendimtar.

Pse kjo narrativë që unë paraqes është e rëndësishme për një qytetar apo ushtarak shqiptar? Kjo analizë është e botuar publikisht për të ndërgjegjësuar çdo individ që e lexon këtë artikull, me qëllim që të dijë si të sillet, nëse individë të “çuditshëm” e kontaktojnë atë për një ofertë “pune të lehtë online” që përfshin përhapje opinionit, fotosh ose “ndihmë teknike”. Kjo mund të jetë e dyshimtë dhe ndodh për një shkak. Njohja e sjelljeve të mediave dhe rrjeteve sociale, kur një qytetar apo ushtarak shqiptar do të shohë sasi jo-normale të përmbajtjeve që krijojnë panik, polarizim, dëmtim të imazhit të lidershit ushtarak dhe politik, atëherë kjo mund të jetë pjesë e operacioneve të ndikimit. Për strukturat e sigurisë kjo qasje jo e re tashmë, nënvizon nevojën për mbrojtje të hapësirës kibernetike, për kontroll më të mirë të hyrjeve, daljeve dhe monitorimit të aktiviteteve të sabota→zhit në infrastrukturën ushtarake dhe atë kritike.

Ekzistojnë shumë prova që sugjerojnë se strukturat ruse mund të jenë duke aktivizuar agjentë ose rrjete të ndikimit në Perëndim, megjithatë është e vështirë të identifikohen me siguri për shkak të natyrës së fshehtë të operacioneve. Ka disa indicie që ekspertët dhe shërbimet e inteligjencës perëndimore i konsiderojnë si tregues të mundshëm të aktivizimit të agjentëve ose operacioneve të ndikimit nga ana e Rusisë në Evropë ose SHBA-së.

Në maj 2025, “AP News”, raporton se autoritetet gjermane ngritën akuza kundër tre personave; një ukrainas, një armen dhe një rus, të cilët akuzohen për spiunazh në favor të një agjencie inteligjence ruse, dhe ekzistonin prova të përgatitjes së një atentati nga ana e tyre. Operacioni sipas Euronës provonte veprime të grupit për të identifikuar personin që kishte luftuar për Ukrainën, duke e tërhequr në një takim të fshehtë në Frankfurt, me qëllim për ta vvarë.

Kjo tregon se Rusia është aktive edhe me operacione të fshehta që mund të përfshijnë veprime të dhunshme, atentate dhe sabotazhe.

Në shtator 2025, autoritetet holandeze arrestuan dy të rinj në Holandë, të dyshuar për spiunazh në favor të një fuqie të Rusisë. Sipas mediave, adoleshentët ishin kontaktuar përmes aplikacionit “Telegram” nga një rrjet “pro-rus” dhe akuzohen nga Europol për spiunazh. Kjo ngjarje thekson trendin e ri që Rusia ose përfaqësues të saj po përdorin me metoda jo tradicionale p.sh. rekrutime adoleshentësh, rrjete hakerësh, për të operuar jashtë kanaleve shtetërore dhe diplomatike. Një person në Letoni është arrestuar dhe akuzohet se ka spiunuar për Rusinë, pasi kishte ndarë informacion mbi trupat e NATO-s që ndodheshin në Letoni si dhe infrastrukturën ushtarake letoneze.

Një hetim i organizatës “Re: Baltica”, në gusht 2025, zbuloi një operacion sabotazhi në vendet baltike dhe të tjera në Evropë. Një profesor rus u dënua me burg në Estoni, pasi akuzohej

për spiunazh në favor të inteligjencës ruse, duke mbledhur informacione mbi mbrojtjen, politikën e sigurisë dhe integrimin social. Po ashtu, shërbimi estonez i sigurisë po paralajmëron se Rusia përgjatë vitit 2024-2025 po rekruton “qytetarë të zakonshëm” në Estoni (jo vetëm funksionarë me qasje në dokumente klasifikuara) për aktivitete inteligjence. Një ish-roje sigurie në ambasadën amerikane në Oslo, në qershor 2025, u dënua pasi u gjet fajtor në spiunazh për Rusinë dhe Iranin. Ai, sipas “The Washington Post”, i kishte dorëzuar informacion mbi diplomatët, planet e ndërtesës, skemat e sigurisë dhe rutinën e ambasadës së SHBA-së në Oslo.

Ka një publikim të zgjeruar me disa nga rastet më të dokumentuara për periudhën 2024-2025 në Evropë (dhe disa lidhje me SHBA-të), që përfshijnë aktivitete të spiunazhit, sabotazhit,



operacioneve hibride nga ana e Rusisë. Për secilin rast unë kam përfshirë edhe referenca për raportet/shpjegimet nga burime publike të besueshme. Edhe pse ka raporte publike dhe dokumente të përfshira në listë, raportet origjinale të inteligjencës (shërbimeve të fshehta) sigurisht nuk janë publike për arsye sigurie kombëtare. Disa raste përfshijnë deklarata të larta zyrtare ose dokumente të shërbimeve vendore, por ato nuk përfshijnë gjithmonë detaje të plota si emra agjentësh, metodologjitë, mënyrën e të vepruarit dhe mbështetësit. Shumica e këtyre rasteve janë të zbuluara në Evropë, ndërsa për SHBA-të ka më pak raste të publikuara me emër të agjentëve rusë, që janë bërë publike për periudhën 2024-25, ose të publikuara deri tani.

Shqipëria është një shënjestër e këtyre operacioneve dhe drejtuar nga këta aktorë shtetërorë, pasi është anëtare e NATO-s dhe kandidate e BE-së. Përveç kësaj vendi ynë ka një sistem politik të polarizuar, që e bën më të lehtë manipulimin dhe çorientimin e opinionit që të ushqehet me pakënaqësi ndaj

institucioneve. Sulmet në medie kundër presidentit të republikës dhe elitës ushtarake kanë sigurisht qëllim të ulin besimin e publikut tek FA-të dhe institucionet e sigurisë. Duhet të punohet për të gjetur përgjigjen e pyetjes magjike në këtë rast; Kush përfiton nga kjo fushatë? Këto dhe plagë të tjera të shoqërisë tonë janë një terren pjellor për propagandën përçarëse ruse. Vendi ynë ka vendndodhje strategjike në Adriatik dhe pas agresionit kundër Ukrainës, Federata Ruse i ka zgjeruar operacionet e saj hibride në gjithë hapësirën euroatlantike. Objektivi i saj madhor është dobësimi dhe prishja e unitetit të NATO-s, duke destabilizuar dhe ndikuar në vendet partnere, përfshirë Ballkanin Perëndimor. Shqipëria, si anëtare besnike e NATO-s dhe mbështetëse e qartë e Ukrainës, është shënjestër potenciale

Financimet e fshehta ose marrëveshjet ekonomike janë duke u përdorur gjerësisht që krijojnë varësi ndaj burimeve ruse. Aktiviteti kibernetik rus vazhdon të ketë target dhe për qëllim të depërtojë në rrjete qeveritare ose sisteme të NATO-s. Në Europë po përdoret gjerësisht rrjeti i “agjentëve të fjetur” ose rekrutimi i personave me profile të ulëta punonjës civilë, teknikë, etj., për detyra operative. Ndërhyrjet në zgjedhje, dezinformimi dhe manipulimi i opinionit publik janë më të vështira për t’u dokumentuar edhe në vendin tonë, por ka arsye dhe terren që mund t’i mbështesë këto. Nostalgjia sovjetike, idiotët e dobishëm por edhe persona të blerë ka shumë gjasa të jenë edhe në politikë, ekonomi dhe studio televizive si analistë.

Efektivët dhe strukturat tona ushtarake

për operacione ndikimi, dezinformimi dhe sabotazhi rus.

Përdorimi i rrjeteve sociale, faqeve anonime dhe mediave alternative, parashikohet të rritet në 2026, për të përhapur narrativa anti-NATO, anti-BE, dhe antiamerikane. Përdorimi i “analistëve” lokalë ose zërave publikë ka shumë gjasa të shtohen për të futur dyshim dhe përçarje në opinion dhe leadership. Këto analistë për të qenë të besueshëm në opinionin publik, bëjnë thirrje “poshtë Rusia”, por nga ana tjetër hedhin akuza, sjellin dezinformacion, përhapin narrativa dhe kryejnë veprime, të cilat janë në favor të Moskës. Në Estoni, në vitin 2024, një major estonez, me dekorata nga lufta në Afganistan, mbante leksione kundër luftës në Ukrainë, por i jepte informacione GRU-së ruse lidhur me aftësinë mbrojtëse, armatimin dhe prezencën perëndimore në ushtrinë estoneze.

Fokusi i këtyre analistëve të “pavarur” te temat e ndjeshme si: korrupsioni, varfëria, emigracioni, është një mjet për të ndikuar në qëndrimet e opinionit publik perëndimor.

janë, por duhet të jenë edhe më të ndjeshme ndaj kontakteve të paaautorizuara ose të pazakonta nga persona të huaj. Ushtarakët tanë nuk duhet t’iu përgjigjen kërkesave për informacione që nuk lidhen me detyrat e tyre si dhe sjelljeve ose komunikimeve të papërshtatshme brenda rrjeteve të punës dhe nëse ndodh duhen raportuar menjëherë në agjencinë tonë të inteligjencës. Auditime të rregullta të sigurisë janë të nevojshme të zhvillohen në bazat tona ushtarake, rrjetet IT dhe pikat e aksesit fizik, duke e kualifikuar dhe informuar personelin me njohuritë e nevojshme mbi luftën informative dhe operacionet psikologjike. Kujdes, ushtarakët tanë sidomos ata me qasje në informacion të aleancës, duhet të kenë me ekspozimin e tyre në rrjete sociale. Ata nuk duhet të komunikojnë apo kontaktojnë për çështje të sigurisë me të panjohur, por të raportojnë menjëherë çdo tentative rekrutimi, kërcënimi, shantazhi ose kontakti të dyshimtë. Siguria kombëtare fillon nga ndërgjegjja personale dhe rezistenca mendore.

Nga një fushë beteje në një mision historik
Në historinë e popullit shqiptar, data 3 nëntor 1443 është më shumë se një kujtim; është një ditëlindje e re e kombit. Në atë ditë, në një moment vendimtar për fatin e popujve të Ballkanit, Gjergj Kastrioti – Skënderbeu, biri i Arbërisë, u kthye nga fushat e betejës në atdheun e tij për të ndezur përsëri flakën e lirisë. Ai u shkëput nga radhët e ushtrisë osmane, ku kishte shërbyer me nder dhe me famë, për t'u bërë udhëheqësi i qëndresës shqiptare kundër një prej perandorive më të fuqishme të botës së asaj kohe.

Rruga e një strategu

I lindur më 1405, në krahinën e Dibrës, Gjergj Kastrioti ishte biri i Gjon Kastriotit, princ i njohur. Fëmijëria e tij mori rrjedhë të dhimbshme kur, si shumë bij princërisht të tjerë, u mor peng nga osmanët dhe u dërgua në oborrin e sultanit në Edrene. Aty, në vend të robërisë shpirtërore, ai fitoi njohuri, disiplinë dhe përvojë ushtarake që më vonë do t'i shërbenin për të ndërtuar një strategji të qëndrueshme lufte për liri.

Në oborrin osman ai u njoh si Iskender bey – “Zot Skënder”, një emër që lidhej me kujtimin e Aleksandrit të Madh, për nga trimëria dhe aftësia në luftë. Brenda perandorisë ai ngjiti shkallët e karrierës ushtarake, por asnjëherë nuk harroi origjinën e tij. Zemra e tij mbeti në Krujë, në malet e Arbërisë, mes njerëzve që ende kujtonin emrin e Kastriotëve si mbrojtës të tokës dhe të besës.

Beteja e Nishit dhe kthesa e madhe

Në vjeshtën e vitit 1443, ushtria osmane mori pjesë në një betejë kundër forcave të krishtera pranë qytetit të Nishit, në territorin e sotëm të Serbisë. Aty, në rrëmujën e luftës, ndodhi një akt që do të ndryshonte rrjedhën e historisë shqiptare. Gjergj Kastrioti, bashkë me disa luftëtarë shqiptarë që i besonin, braktisi ushtrinë osmane dhe mori rrugën drejt Arbërisë. Ky nuk ishte një dezertim i zakonshëm, ishte një kthesë e menduar mirë, një akt strategjik dhe atdhetar.

I veshur me përvojën e betejave dhe i mbushur me urrejtje ndaj robërisë, Skënderbeu mori me vete një dokument të falsifikuar që i jepte të drejtën të merrte në dorëzim Kalanë e Krujës në emër të sultanit. Por në vend të vulës së sultanit, në muret e saj do të valëvitej për herë të parë pas shumë vitesh flamuri i kuq me shqiponjën e zezë dykrenare, simboli i Arbërisë së lirë.

Rilindja e një shteti dhe thirrja për bashkim

Me marrjen e Krujës, Skënderbeu shpalli shkëputjen e Arbërisë nga Perandoria Osmane. Brenda pak javësh, princër e kapedanë nga të gjitha anët e vendit iu përgjigjën thirrjes së tij. Në mars të vitit 1444, në qytetin e Lezhës, nën drejtimin e Skënderbeut u mblodhën përfaqësuesit e familjeve më të fuqishme arbërore: Arianitët, Dukagjinët, Topiajt, Muzakajt, Zahariajt dhe të tjerë. Aty lindi Lidhja e Lezhës, një organizim politik dhe ushtarak që përfaqësonte për herë të parë në historinë e shqiptarëve një bashkim të vërtetë kombëtar.

Ky ishte fillimi i shtetit arbër nën Skënderbeun, i cili për më shumë se dy dekada do t'i qëndronte përballë një perandorie që kishte pushtuar tri kontinente.

Udhëheqësi, diplomati dhe strategu i epokës

Skënderbeu nuk ishte vetëm një luftëtar i madh, ai ishte një udhëheqës vizionar. Ai kuptoi se fitorja e Arbërisë nuk mund të arrihej vetëm me forcën e shpatës, por edhe me diplomaci. Ai mbajti marrëdhënie të ngushta me Napolin, Vatikanin, Venedikun dhe me shtete të tjera të Evropës, duke i bindur se lufta e tij ishte pjesë e përpjekjes së përbashkët për mbrojtjen e krishterimit dhe të qytetërimit evropian nga pushtimi osman.

Nën udhëheqjen e tij, ushtria arbërore u bë një forcë e disiplinuar, me një taktikë të re lufte që kombinonte njohuritë e fituara në ushtrinë osmane me mjeshtërinë e luftës malore shqiptare. Kështjellat e Krujës, Petrelës, Stelushit, Modrisës e deri te Berati, u kthyen në simbole të qëndresës dhe krenarisë.

Qëndresa që frymëzoi Evropën

Në shekullin XV, kur shumë kombe të tjera ishin nën zgjedhën osmane, Arbëria e Skënderbeut qëndroi si një ishull lirie në zemër të Ballkanit.

Për 25 vjet me radhë, ai mundi ushtri të shumta osmane të drejtuara edhe nga vetë sultanët Murati II dhe Mehmeti II, pushtuesi i Kostandinopojës. Fitorja e tij në Krujë (1450), në Mokër (1445), në Oranik (1456)

3 Nëntor 1443

Kthimi i Skënderbeut: Rilindja e Arbërisë dhe Zgjimi i Një Kombi



e në shumë beteja të tjera, e bëri emrin e Skënderbeut të jehonte në oborret evropiane si simbol i trimërisë dhe i qëndresës.

Humanistët e kohës e quajtën “Atleti i Krishtit”, ndërsa populli e shpalli “shpëtimtarin e Arbërisë”. Ai u bë frymëzim për breza të tërë, jo vetëm për shqiptarët, por për të gjithë ata që besonin se liria është e drejtë e lindur e çdo populli.



PORTRETI I VETËM
ORGJINAL I SKENDERBEUT

Trashëgimia që nuk shuhet

Kur Skënderbeu ndërroi jetë, më 17 janar 1468, në Lezhë, ai la pas një trashëgimi që s'e shuan as koha. Pas vdekjes së tij, Arbëria u përfshi përsëri në vorbullën e pushtimeve, por ideali i bashkimit dhe i lirisë që ai mbolli, nuk u shua kurrë. Ai u kthye në simbol të pavdekshëm të qëndresës, të besës dhe të dashurisë për atdheun.

Shekuj më vonë, rilindësit shqiptarë e morën figurën e tij si flamur frymëzimi për ringritjen kombëtare. Në çdo etapë të historisë sonë, nga Lidhja e Prizrenit e deri te pavarësia e vitit 1912, emri i Skënderbeut është thirrur me nderim, si zëri i ndërgjegjes së kombit.

Skënderbeu në kujtesën e sotme kombëtare dhe ushtarake

Për Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, Skënderbeu nuk është thjesht një figurë historike, por themeli i traditës luftarake shqiptare. Disiplina, strategjia, besa dhe dashuria për tokën, janë vlerat që buruan nga koha e tij dhe që mbeten udhërrëfyese edhe sot.

Në çdo akademi ushtarake shqiptare, në çdo paradë e nderim, në çdo flamur e uniformë që mban emrin e tij, gjallon fryma e Skënderbeut, fryma e atij që e ktheu popullin e vet në një komb që dinte të qëndronte ballëlartë përpara çdo pushteti.

3 Nëntori, si ditë kujtese kombëtare

3 Nëntori nuk është vetëm dita e kthimit të një princi në atdhe. Është dita e kthimit të besimit në vetvete, dita kur Arbëria rilindi në arenën e historisë botërore si shembull i qëndresës së një populli të vogël, por me shpirt të madh.

Skënderbeu u kthye jo vetëm për të çliruar tokën e tij, por për të rilindur një ndërgjegje kombëtare që do t'i rezistonte shekujve.

Në kujtesën tonë, kjo datë mbetet gur themeli i historisë shqiptare, një kujtesë e gjallë për çdo brez, që dashuria për atdheun dhe liria nuk dhurohen, ato fitohen me besë, mençuri dhe sakrificë.

Kur gratë shqiptare ndërtuan themelet e lirisë dhe barazisë

Në Berat, qytetin e bardhë të historisë, 311 gra dhe vajza nga e gjithë Shqipëria u mbledhën për herë të parë për të vendosur fatin e tyre dhe të vendit. Ishte Kongresi i Parë i Bashkimit të Grave Antifashiste Shqiptare një ngjarje që ndryshoi përgjithmonë rolin e gruas në shoqërinë tonë.

Një kongres që lindi nga lufta dhe shpresa

Në vjeshtën e vitit 1944, ndërsa Shqipëria po çlirohej hap pas hapi nga pushtuesit nazifashistë, qyteti i Beratit u kthye në qendër të vendimmarrjes kombëtare. Pikërisht aty, më 4 nëntor 1944, u hap solemnisht Kongresi i Parë i Bashkimit të Grave Antifashiste Shqiptare (BGASH), një ngjarje që do të hynte në histori jo vetëm si akt politik, por si fillimi i emancipimit të gruas shqiptare.

Në sallën e stolisur me flamuj dhe portrete të dëshmorëve, 311 delegate nga të gjitha krahinat partizane, nëna dëshmorësh, gra të fshatit e të qytetit u ngritën zërin e tyre për barazi, arsim dhe dinjitet. Ishte hera e parë që gratë shqiptare merrnin pjesë në një forum të tillë kombëtar, ku flitej me forcë për të ardhmen.

“Ne nuk jemi vetëm nëna e motra të luftëtarëve, jemi luftëtare dhe ndërtuese të së ardhmes sonë!”, ishte një nga mesazhet që përshkoi sallën.

Gratë e Beratit dhe Skraparit, zëri i guximit dhe sakrificës

Berati, si mikpritës i Kongresit, dha shembullin e vet me një përfaqësim të denjë: Elpiza Laçka, Argjiro Leka, Efigjeni Tutulani, Feruze Zotkaj, Urani Mullisi (Kudra), Shpresa Fuga, Myzaferë Doko, Fato Rino, Nazike Dyrmishi, Vita Shyti dhe shumë të tjera.

Nga Skrapari mbërritën gra të kalitura në betejat e maleve: Ganimet Hysi, Zenepe Dobrusha, Bukurie Çepani, Ruze Cerova, Dare Daja, Bule Veleshnja e të tjera, të gjitha me rrugë të përflakur nga luftërat dhe idealet.

Ato sollën me vete historitë e rezistencës, dhimbjen e humbjeve, por edhe forcën e ringritjes. Në sytë e tyre ndizej i njëjti besim: se pas çlirimit do të vinte koha e barazisë së gruas shqiptare.

Dokumentet që ndryshuan epokën

Kongresi miratoi një sërë dokumentesh themelore, ku u përcaktuan qartë detyrat e grave shqiptare në rindërtimin e vendit dhe lufta kundër analfabetizmit. Ishte momenti kur për herë të parë në historinë tonë u shpall hapur se gruaja shqiptare është e barabartë me burrin në çdo fushë të jetës shoqërore, politike e ekonomike.

Në ditët e Kongresit, delegatet vizituan familjet e dëshmorëve të Beratit, si Margarita Tutulani dhe Kristaq Cepo, duke nderuar me lot e këngë kujtimin e tyre. Ndërsa në mbyllje, rrugët e qytetit kumbuan nga këngët partizane dhe thirrjet e gëzueshme: “Rroftë Shqipëria e lirë! Rroftë gruaja shqiptare e re!”

Himni i Kongresit, zëri i lirisë

Në pavijonin e Luftës Antifashiste të Muzeut Historik të Beratit, ruhen ende fjalët e himnit që shoqëroi atë moment historik:

**“Ja ora po bie dhe muret e zeza,
që ndanin nga jeta po shemben që sot,
se gruaja shqiptare ndërtoi në kongres,
themelet e lirisë për jetë e për mot.”**

Ky refren kumbon ende sot si një thirrje për vazhdimësi, për të kujtuar se barazia dhe dinjiteti nuk janë dhuratë, por fitore që kërkojnë përpjekje dhe bashkim.

Trashëgimia e pavdekshme e 4 Nëntorit

Sot, 81 vjet më vonë, fryma e atij Kongresi vazhdon të jetojë në çdo vajzë e grua shqiptare që studion, punon, udhëheq dhe ndërton jetën me dinjitet.


Kongresi i Parë i Grave Antifashiste, zëri i gruas që ndryshoi Shqipërinë



Gruaja shqiptare është pedagoge, oficerë, sipërmarrëse, ministre, diplomate pjesë e pandashme e zhvillimit demokratik të vendit. Kongresi i Parë i Grave Antifashiste mbetet gur themeli i emancipimit shqiptar, një moment kur gratë jo vetëm kërkuan

të drejta, por i fituan ato me zërin, guximin dhe sakrificën e tyre.

Në Berat u hodhën themelet e lirisë së gruas shqiptare. Dhe ato themele, ende sot, mbajnë peshën e një shoqërie që ecën përpara, krah për krah, burra dhe gra.





Inteligjenca artificiale po riformëson botën e punës: Aftësitë e së ardhmes janë tashmë një domosdoshmëri

Ndërsa inteligjenca artificiale po përhapet me shpejtësi në çdo sektor, liderët e teknologjisë paralajmërojnë se tregu i punës do të përjetojë një transformim të thellë. Profesione të tradicionale do të ndryshojnë, disa do të zhduken, dhe aftësitë e reja – nga mendimi kritik te përdorimi i mjeteve digjitale – do të bëhen thelbësore për suksesin.

Industria e teknologjisë po përjeton aktualisht shkurtime intensive të vendeve të punës të nxitura nga inteligjenca artificiale. Ndërsa inteligjenca artificiale merr përsipër detyrat e kryera më parë nga njerëzit, dera për punësime të reja po ngushtohet më tej, papunësia e të rinjve është rritur ndjeshëm, me punësimin që po përkeqësohet për katër tremujorë radhazi – më e keqja në nëntë vjet.

A do t'i humbasin njerëzit të gjitha vendet e tyre të punës ndërsa AI-ja vazhdon të përparojë? A mund të zhduken plotësisht disa kategori pune? Çfarë aftësish do të nevojiten në këtë epokë të “pushimeve nga puna të nxitura nga AI-ja? Ne kemi mbledhur informacione nga liderët e industrisë së teknologjisë.

Parashikimet sugjerojnë se AI-ja, jo vetëm që do të zëvendësojë vende pune specifike, por pothuajse të gjitha profesione. Ndërsa diskutimet rreth agjentëve të kodimit të AI-së që zëvendësojnë zhvilluesit ose punonjësit e rinj me një deri në dy vjet përvojë kanë vazhduar, AI-ja tani ka përparuar për të tejkaluar edhe aftësitë e nivelit të doktoraturës. Robotët e pajisur me AI po zhvillohen gjithashtu për të njohur dhe vepruar në mjedis në kohë reale. Ky kontekst nxit pritjet se gama e vendeve të punës që po zhduken do të zgjerohet ndjeshëm. Elon Musk, CEO i Tesla-s, komentoi mbi pushimet masive nga puna të Amazon nëpërmjet mediave sociale X, duke shkruar: “AI-ja dhe robotët do të zëvendësojnë të gjitha vendet e punës”. Sam Altman, CEO i OpenAI, deklaroi gjithashtu: “Vetë kategoritë e punës mund të zhduken”.

Edhe nëse vendet e punës mbeten, AI-ja pritet të riformësojë

në mënyrë drastike punën. Ndërsa AI-ja integrohet në të gjitha aspektet e detyrave, natyra e punës kritike dhe aftësitë e kërkuara do të ndryshojnë. Jensen Huang, CEO i NVIDIA, tha në një intervistë në korrik me CNN: “Jam 100% i sigurt se vendet e punës të të gjithëve do të ndryshojnë. Gjatë epokës së kompjuterëve, pamë që produktiviteti dhe rritja e vendeve të punës bashkëjetojnë”.

Cilët sektorë do të përballen të parët me shkurtime nga puna ose transformime?

Analistët parashikojnë se rolet e bazuara në zyrë me ndërveprim minimal ballë për ballë do të preken më shumë. Brenda vendeve të punës në zyrë, ekipet e burimeve njerëzore dhe të kontabilitetit – në vend të roleve të shitjeve që përfshijnë ndërveprim të drejtpërdrejtë me klientët – pritet të mbajnë





peshën kryesore. Amazon, e cila njoftoi një plan për të pushuar nga puna 14,000 njerëz, thuhet se shënjestroi shumë në role administrative, përfshirë HR. Andy Jassy, CEO i Amazon, dërgoi një mesazh të brendshëm duke deklaruar: “Përshtatja e AI-së gjeneruese do të zvogëlojë madhësinë e fuqisë punëtore të bazuar në zyrë gjatë viteve të ardhshme”. Bashkëthemeluesit e “Anthropic” i thanë gjithashtu “Axios” në shtator: “Gjysma e vendeve të punës në nivel fillestar me jakë të bardhë mund të zhduken brenda pesë viteve”. Një studim i Microsoft (MS) zbuloi se rolet e thjeshta të zyrës, të tilla si futja e të dhënave dhe përmbledhja e dokumenteve, janë më të rrezikuara. IBM shtoi: “Një pjesë e konsiderueshme e operacioneve të zyrës së prapavijës që nuk kanë të bëjnë me klientët, mund të automatizohen”.

Çfarë aftësish nevojiten për të qëndruar i punësuar?

Udhëheqësit e teknologjisë theksojnë: “Përqendrohuni në atë që doni të bëni dhe në atë që jeni të mirë, siç keni bërë gjithmonë - por bëjeni me AI.” Jensen Huang theksoi: “Ne

nuk do të zëvendësohemi nga AI-ja, por nga ata që e përdorin AI-në në mënyrë efektive”. Sam Altman vuri në dukje: “Kjo është koha më e mirë për të filluar një biznes. Bëni atë që ju plotëson dhe ju pasuron”.

Disa argumentojnë se ndërsa AI-ja eliminon vende pune, ajo gjithashtu do të krijojë vende të reja pune. Vellachi Shankaralingam, presidenti i produkteve dhe inxhinierisë së Zoom, tha në një intervistë, më 30 shtator, me gazetarët koreanë: “Të gjithë shqetësohen se AI-ja do të zëvendësojë njerëzit dhe është një sfidë e vështirë. Por unë personalisht besoj se vende të reja pune - si siguria e AI-së dhe menaxhimi i agjentëve të AI-së, do të shfaqen”. Microsoft, duke njoftuar plane të reja punësimi, deklaroi: “Ne do të rrisim produktivitetin e punonjësve me AI dhe do të vazhdojmë punësimin”.

Inteligjenca Artificiale dhe Tregu i Punës në Shqipëri, një transformim i pashmangshëm

Në dekadën e fundit, inteligjenca artificiale ka kaluar nga një koncept futurist në një realitet të prekshëm që po ndryshon rrënjësisht mënyrën si jetojmë dhe punojmë. Shqipëria, ndonëse

me ritme më të ngadalta krahasuar me vendet më të zhvilluara, po përjeton gjithashtu ndikimin e këtij revolucioni teknologjik. Integrimi i AI-së në sektorë të ndryshëm të ekonomisë shqiptare ka nisur të ndikojë drejtpërdrejt në tregun e punës, duke ngritur pyetje të rëndësishme mbi të ardhmen e profesioneve tradicionale, nevojën për ritrajnim dhe rolin e njeriut në një botë gjithnjë e më të automatizuar.

Në sektorin e shërbimeve, veçanërisht në call center-a dhe administratë, AI-ja po zëvendëson detyra të përsëritshme dhe rutinë përmes sistemeve të automatizuara të komunikimit dhe menaxhimit të të dhënave. Kjo ka sjellë një ulje të kërkesës për punonjës që kryejnë funksione bazike, duke e bërë të domosdoshëm kalimin drejt roleve që kërkojnë aftësi më të avancuara digjitale. Ndërkohë, në sektorin financiar dhe atë të teknologjisë, përdorimi i AI-së për analizën e të dhënave, parashikimin e tregjeve dhe menaxhimin e riskut po krijon vende të reja pune për profesionistë të specializuar, por vetëm për ata që kanë ndjekur ritmin e zhvillimeve teknologjike.

Megjithatë, AI-ja nuk po i zëvendëson njerëzit në mënyrë absolute. Ajo po ndryshon natyrën e punës, duke zhvendosur fokusin nga detyrat mekanike drejt atyre që kërkojnë kreativitet, mendim kritik dhe ndërveprim njerëzor. Profesione si edukatorë, psikologë, dizajnerë dhe menaxherë po mbeten të rëndësishme, madje po fitojnë më shumë vlerë në një mjedis ku teknologjia nuk mund të zëvendësojë ndjeshmërinë dhe intuitën njerëzore. Në këtë kontekst, edukimi dhe ritrajnimi po bëhen faktorë kyç për mbijetesën profesionale. Universitetet dhe institucionet arsimore shqiptare po përballen me sfidën e përshtatjes së kurrikulave për të përgatitur studentët për një treg pune që kërkon aftësi të reja, si programim, analizë të të dhënave, menaxhim sistemesh AI dhe komunikim ndërkulturor.

Ndërkohë, Shqipëria duhet të krijojë politika të qëndrueshme që mbështesin tranzicionin e fuqisë punëtore. Investimet në infrastrukturë digjitale, subvencionet për trajnime teknologjike dhe nxitja e inovacionit janë hapa të domosdoshëm për të siguruar që Shqipëria të mos mbetet pas në garën globale për zhvillim. Nëse AI-ja përdoret si mjet bashkëpunimi dhe jo si zëvendësues, ajo mund të sjellë një epokë të re prosperiteti dhe efikasiteti për vendin.

Në fund, integrimi i inteligjencës artificiale në tregun e punës shqiptar nuk është një kërcënim, por një thirrje për ndryshim. Është një mundësi për të rishpikur veten, për të mësuar aftësi të reja dhe për të ndërtuar një ekonomi më të fortë, më të zgjuar dhe më të drejtë. Sfidë qëndron në mënyrën si e përballojmë këtë transformim: me frikë, apo me kurajë dhe vizion.



Gazeta "Ushtria" - në shërbim të vlerave kombëtare, dinjitetit dhe paqes.

Redaksia e gazetës

Pikëpamjet, opinionet dhe analizat e shprehura në gazetën "Ushtria" janë tërësisht të gazetarëve apo autorëve të materialeve respektivë, sjellë pranë redaksisë së kësaj medie dhe jo domosdoshmërisht pasqyrojnë politikat apo pozicionet zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes, dhe Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.



Qendra e Personel Rekrutimit njofton se do të rekrutojë kandidatë për studime në Akademitë Ushtarake të Shteteve të Bashkuara të Amerikës

JANË NË DISPOZICION 3 (TRE) TË
DREJTA STUDIMI, SI MË POSHTË:



Akademia Ushtarake "West Point"

1 (një) kuotë

Akademia Ushtarake Detare

1 (një) kuotë

Akademia Ushtarake e Forcave Ajrore

1 (një) kuotë

Afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit pranë Qendrës së Personel Rekrutimit është 14 nëntor 2025.

Për më shumë informacion, ju lutem na kontaktoni në numrin e
tel. 0035542348588,
WhatsApp +355 68 340 4896